

UNIVERSITETI I GJAKOVES “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: LETËRSI SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Tema: Kryevepra e letërsisë shqipe: romani “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”

MENTORJA:

Dr.Rovena Vata

KANDIDATI:

Besart Ukaj

Gjakovë, 2018

UNIVERSITETI I GJAKOVES "FEHMI AGANI"

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: LETËRSI SHQIPE



Tema: Kryevepra e letërsisë shqipe: romani "Gjenerali i ushtrisë së vdekur"

Komisioni:

Kryetar _____

Anëtar _____

Anëtar _____

MENTORJA:

Dr.Rovena Vata

KANDIDATI:

Besart Ukaj

Gjakovë, 2018

FALENDERIME:

Së pari e falënderoj familjen time për mbështetjen e tyre e cila vazhdimisht më ka përkrahur, gjatë gjithë kësaj periudhe të rrugëtimit tim si student. Falënderoj të gjithë profesoret e “Fakultetit të Filologjisë” e në veçanti mentoren Dr. Rovena Vata për angazhimin, përkrahjen dhe sugjerimet e saj gjatë këtyre viteve akademike.

PASQYRA E LËNDËS:

HYRJE.....	6
1. Objekti dhe motivimi i temës.....	6
2. Metodologjia dhe metodat e punës.....	8
3. Baza teorike e punimi.....	9
4. Synimi i temës.....	9

KREU I

Ismail Kadaresë, jeta dhe vepra e tij.....	10
1.1 Jeta dhe vepra e Ismail Kadaresë	10

KREU II

Analiza e titullit të romanit.....	12
2.1 Simbolika e ushtrisë së vdekur	12
2.2 Titulli grotesk dhe paradoks	12
2.3 Realja dhe jorealja	12

KREU III

Shtjellimi i romanit.....	13
3.1 Ngjarje groteske.....	13
3.2 Personazhë groteskë.....	14
3.3 Skena groteske	15

KREU IV

4.1 Fabula e romanit.....	16
---------------------------	----

4.2 Skena melodramatike.....	17
4.3 Mbledhja e eshtrave të ushtarëve të vrarë.....	17

KREU V

5.1 Fantastika dhe realja në roman.....	19
5.2 Bota e gjallë dhe bota e vdekur.....	19
5.3 Elemente të baladave shqiptare në roman.....	19

Përfundime	20
-------------------------	-----------

Bibliografia	22
---------------------------	-----------

HYRJE

1. Objekti dhe motivimi i temës

Qëllimi i këtij punimi është trajtimi i veprës letrare të shkrimtarit tonë të mirënjohur Ismail Kadaresë, përkatësisht romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”.

Në romanin Gjenerali i ushtrisë së vdekur trajtohet tema rreth një gjenerali italian i cili është dërguar në Shqipëri për të gjetur eshtrat e ushtarëve të rënë italian gjatë kohës së pushtimit të Shqipërisë.

Detyrë kryesore që shkrimtari e trajton në roman është gjetja e eshtrave të një koloneli i cili u zhduk në një fshat të vogël shqiptar.

Gjenerali në fillim të udhëtimit të tij paraqitet i mbushur më entuziazëm për “misionin” e tij historik në të njëjtën kohë del se gjenerali ka pritur të takojë njerëz të egër dhe barbare por ndodh e kundërta sa me shumë njeh nga afër popullin shqiptar aq më shumë ai ka dashamirësi për ta.

Personazhet në roman nisin të shtohen dhe kjo shton dramën e gjeneralit, duke nisur si një mision monoton, duke ndryshuar më vonë më gjetjen e ditarit gjë e cila lë gjurmë tek gjenerali dhe duke vazhduar tek dasma që e përball gjeneralin më të vërtetën e hidhur.

Pra ky roman na paraqitet i tillë më ndryshime të thella psikologjike jo vetëm kaq, është një udhëtim nëpër një vend të frikshëm, të huaj dhe misterioz dhe udhëtarët mësojnë se nuk mund ti kapërcejnë kufijtë e vdekjes. Një udhëtim nëpër botën e të vdekurve sa me tepër zgjat kjo sipërmarrje e çmendur aq më e pakuptimtë nis ti duket e gjitha kjo gjeneralit.

Hap pas hapi të vdekurit e shkulim nga pozitat e njeriut sundimtar siç paraqitej në fillim dhe e çojnë deri aty sa ai pranon plagët që hap lufta janë të pashërueshme.

Vepra për herë të parë në bullgarisht doli më (1966), në serbisht (1968) dhe në turqisht (1968), kur në Shqipëri nuk ishin fashitur vërejtjet e kritikës së realizmit socialist, madje në bullgarisht, kur shkrimtari ende nuk kishte nxjerrë motërzimin e tij të dytë (1967), që është motërzimi kryesor.

Bullgarishtja është gjuha e parë që i hapi dyert për librin “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, romanit më të njohur në botë të Kadaresë, kurse greqishtja është e katërta midis gjuhëve të botës, konkretisht pas frëngjishtes, anglishtes dhe gjermanishtes, në të cilën janë përkthyer më tepër tituj prej tij. Por gjuhët dhe letërsitë ballkanike nuk kishin as mundësinë dhe as besueshmërinë e mjaftueshme për ta përcjellë përtej gadishullit të tyre.

Në këtë endje prove “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, sikurse dhe romanet e tjerë më vonë, kërkonte hapësirat e veta të mëdha për të cilat ishte krijuar, pasi Ballkani dashamirës dhe djepi i tij ishte i ngushtë për të. Shqipëria zyrtare, që i kishte rrënuar urat kulturore të ndërsjella me krejt Perëndimin, vetëm me Francën kishte lejuar një lloj marrëdhënie.

Kjo urë ndërlidhjeje e paprishur plotësisht, sikurse edhe botimi frëngjisht në Tiranë që pati “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (1968) e ka lehtësuar mbërritjen e tij, pikërisht, në Francë, në qendrën botërore të provës dhe të miratimit të vlerave të mëdha letrare.

2. Metodologjia dhe metodat e punës

Për të realizuar këtë temë diplome na kanë ardhur në ndihmë disa metoda studimi. Si fillim metodën e krahasimit, e cila është një metodë që na ka shërbyer për të krahasuar elementet e romanit, veçoritë e përbashkëta dhe dallimet që mund të na dalin gjatë studimit të kësaj teme. Metodën e përshkrimit, ku përmes detajeve të gjetura në roman kemi përshkruar karakteristikat kryesore të personazheve të romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, ajo metodë e cila është përdorur e ndërthurur në përshtatje me temën që kemi trajtuar është metodën psikologjike, emocionale e sociale.

Të Gjenerali i ushtrisë vdekur trajtohet fati i kobshëm i ushtrisë pushtuese dhe qëndresa e popullit shqiptar pra bëhet krahasimi mes tyre, po ashtu në këtë roman shihet edhe besnikëria dhe mikpritja e popullit shqiptar në vendin e tyre ashtu siç e kishin traditë gjithmonë.

Pra më konkretisht do ta sqaroj veprën e gjeneralit shkuarjen e tij në truallin shqiptar gjetjen e eshtrave përballjen më vështiresi të shumta po ashtu edhe mikpritjen gjë që as nuk e kishte menduar kurrë, sepse ai mendonte se shqiptaret janë njerëz të egër dhe posa shkoj në Shqipëri e pa që ishte krejt e kundërta, pra këtu shihen edhe vlerat e popullit shqiptar që i kishte gjithmonë e disa prej tyre janë të cekura edhe në kanun si nderi, besa etj.

3. Baza teorike e punimit

Për të marrë në analizë krijimtarinë e Ismail Kadaresë nuk na mungojnë burimet e literaturës që të mbështetemi në studimin tonë, burimet kryesore për të analizuar temën që kemi përzgjedhur janë disa burime si më poshtë:

-Së pari nga vetë autori,romani i tij Gjenerali i ushtrisë së vdekur,botimi i vitit 2005 dhe viti i botimit 2015.

-Së dyti nga shfrytëzimi i studimeve që janë bërë rreth kësaj figure, monografi studimore, kritikës letrare të huaj dhe shqiptare, nga shtypi i kohës apo nga periodikë të ndrrshëm që i kemi parë të arsyeshëm t'i sjellim së bashku me punimin.

4. Synimi i temës

Synimi kryesor i këtij punimi është zbërthimi i romanit të Ismail Kadaresë Gjenerali i ushtrisë së vdekur nga ana letrare dhe psikologjike përmes çështjes të cilat do t'i trajtojmë sipas krerëve përkatës, ku njohja dhe gjetja e elementëve përbërës të këtij romani do jenë synimi i studimit gjatë gjithë punës. Në romanin Gjenerali i ushtrisë vdekur synimi i temës është një ngjarje të cilën vetë autori e ka derdhur në toposin sugjestiv fantastik, frikëndjellës dhe erotik të një romantike tmerri, sepse në këtë roman që habitshëm sillet në vetvete, që fillon vazhdimisht rishtazi dhe që modifikon motivet vërtet është fjala për zhgroposjen, katalogjizmin, kthimin në shtëpi të një armate pushtuese.

Toka e Shqipëris duhet t'i kthejë kufomat e armiqve të dikurshëm në mënyrë që ata të varrosen në vendlindjen e tyre matanë detit.

KREU I

Ismail Kadaresë, jeta dhe vepra e tij

1.1 Jeta dhe vepra e Ismail Kadaresë

Ismail Kadare ka lindur në vitin 1936 dhe është njëri prej shkrimtarëve më të shquar bashkëkohorë, ku është nominuar shumë herë për marrjen e çmimit “Nobel” në letërsi.

Ai shquhet qoftë në poezi, qoftë në prozë, ndersa emrin e tij e mori më prozën letrare Ismail Kadare ai nisi të shkruajë kur ishte ende i ri.

Deri më sot veprat e tij janë përkthyer në mbi dyzetëpesë gjuhë të botës.

Ismail Kadare njihet si shkrimtar i cili veprat e tij në mënyrë të qëllimshme u shtangen nga realizmi socialist, dhe si i tillë veprat e tij u përkthyen dhe u lavdëruan nga kritikët dhe lexuesit anembanë botës.

Ai krijoi një vepër me karakter universal, por që rrënjët i ka thellë në traditën dhe tokën shqiptare.

Ismail Kadare konsiderohet nga disa si një nga shkrimtarët dhe intelektualët më të shquar evropianë të shekullit të 20- të, si dhe një zë universal kundër totalitarizmit.

Tek Kadareja emancipimi, d.m.th. prirja bashkëkohore, qytetëruese e progresive është një tipar që jo vetëm manifestohet e derdhet në çdo ind të vepës së tij letrare, por që kthehet në faktor ndikues edhe në procesin letrar të kohës.

E parë në tërësi, vepra e Kadaresë shfaqet si një univers që të trondit më galerinë e pafund të personazheve, më trajektoret e hedhura mes epokave, më groteskun e tragjizmin njerëzor, më lirizmin.

Ismail Kadare është autori më përfaqësues i letërsisë shqipe, krijimtaria artistike e të cilit ka krijuar relacion organik me identitetin kulturor të shqiptarëve dhe është pasqyrimi më i mirë i tij. Vepra letrare e Kadaresë ka kapërcyer kufijtë gjuhësorë dhe etnikë shqiptarë dhe zë vend meritore në hierarkinë e letërsisë së përbotshme me vlerat e dallueshme artistike, ajo është bërë objekt i studimeve të shumta dhe përbën një materie kuptimplote për të njohur Shqipërinë dhe shqiptarët: në planin historik, kulturor, etnik e identitar.

Në këtë tekst, unë synoj t’i interpretoj marrëdhëniet ndërtekstore të letërsisë së tij me identitetin, kulturën dhe historinë, një trekëndësh nëpërmjet të cilit vepra e tij formëson peizazhin origjinal kadarean dhe, në anën tjetër, *trigon Shqipërinë e përherëshme kulturore*.¹

Peizazhi tematik i romaneve të Kadaresë është sfondi i jetës shqiptare, i parë në kontekstin historik e aktual.

¹ Ymer Çiraku, Në zberthim të kodeve letrare, Toena, Tiranë, 1998, f.86.

Kadare ka dëftuar se ka talent të jashtëzakonshëm për ta mbajtur pezull lexuesin, duke e shëtitur mjeshtërisht nëpër kohë dhe hapësirë, dhe bashkë me galerinë mahnitëse të personazheve të tij, lexuesi zbulon gjithmonë mënyra të reja të perceptimit të universit tonë.

E duke pasur si topose temat e dramat ballkanike, autori atyre gjithmonë iu jep një përmasë homerike të rrëfimit, ku konflikti është gjithmonë prezent, e ku domosdoja që ai të zgjidhet, është në përkim me kërkesat e artit letrar, drejt efekteve të katharsisit.

Krijimtarinë letrare Ismail Kadare e kishte filluar në vitet pesëdhjetë si poet me përmbledhjet poetike Frymëzimet djaloshare të botuara në vitin 1954, Ëndërrimet të botuara në vitin 1957 dhe Shekulli im i botuar në vitin 1961, të cilat dëshmojnë frymëzimin dhe talentin e tij prej shkrimtari. Poezia e tij lëvront temat letrare, historike, jetën e shqiptarëve në veçanti dhe antropologjinë kulturore në përgjithësi.

Ajo çka Ismail Kadarenë e bëri të t'i nisë fama e tij e cila është prezente edhe sot e kësaj dite është romani i tij i parë në prozë dhe më e njohura deri më sot, që ka parë më së shmti dritën e përkthimit, romani Gjenerali i ushtrisë së vdekur i botuar në vitin 1963. Ky roman trajtonte vitet dhe ngjarjet e para të pasluftës, të cilat ja jepen të pasqyruara sipas gjeneralit italian i cili ndodhet i shoqëruar nga një prift në Shqipëri dhe misioni i tyre ishte çvarrosja dhe riatdhesimi i kockave të ushtarëve të rënë në vendin tonë.

KREU II

Analiza e titullit të romanit

2.1 Simbolika e ushtrisë së vdekur

Në romanin gjenerali i ushtrisë vdekur shkrimtari Ismail Kadare në titull ushtria e cilëson si të vdekur, prandaj fjala ushtri është shndërruar në të kundërtën e vet.

Titulli ushtri e vdekur që është shumë origjinal, përfton një shëmbëlltje letrare të pazakonshme të pabesueshme dhe mjaft tërheqëse.

Stigma ushtri e vdekur është e pazakonshme, madje logjikisht e papranueshme, sepse ushtria është jo vetëm e gjallë, *por edhe mishërim i forcës njerëzore më të fuqishme.*²

2.2 Titulli grotesk dhe paradoks

Në letërsi ka përftesa groteske, të cilat janë mënyra trajtimi të stërzmadhuara të dukurive komike, të shëmtuara, tmerruese.

Këto për shkak të funksioneve të tyre të rëndësishme, zakonisht, janë në themel të veprave groteske.

Ushtria e vdekur është një abstraksion simbolizues për një tragjedi, por është edhe një grotesk dhe paradoks, sepse ofron një shëmbëlltje letrare fantazmogonike.

Titulli është formuar mbi gjedhën e jetës së përditshme, konkretisht është formuar mbi gjedhën: ushtria fashiste dhe gjenerali i ushtrisë fashiste, që kanë qenë terma karakteristik të asaj periudhe, *fashizmi si çdo sistem tjetër luftësjellës është barazuar me vdekjen.*³

2.3 Realja dhe jorealja

Si gjithmonë të Kadareja është pamundur të vendosësh fakte, realja përvidhet, tretet ose merr forma tjera më logjikën.

Nuk bëhet fjalë për subjektivitetin e thjeshtë njerëzor ose të mosrjedhshmërisë së dëshirës ose të rindërtimeve.

Si reale në roman shihet shkuarja e gjeneralit më priftin për ti mbledhur eshtrat e ushtarëve të vrare në luftën e fundit që kishte ndodhur, ndërsa si diçka jo reale paraqitet bashkëjetimi i botës së gjallë dhe asaj të vdekur gjë që ishte diçka e pazakontë në botën reale.

² Kadare, Ismail, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Onfuri, Prishtinë, 2015, f.15.

³ Kadare, Ismail, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Onfuri, Prishtinë, 2015, f.55.

KREU III

Shtjellimi i romanit

3.1 Ngjarje groteske

Ringjallja e të vdekurve është përftesa groteske më e fuqishme, rreshtimi i skeleteve udhëtimi i tyre i rikujton gjeneralit paradat madhështore dhe tmerret e shkaktuara. Grotesku është edhe të fakti se e gjithë ushtria e vdekur njësohet më pesë punëtorë shqiptar, gjenerali dhe prifti barazohen me puntoret e komunales.

Ky barazim sjell përftesën groteske të zhvlerësimit të madh emocional të gjeneralit e priftit, ushtarët e sakrifikuar zëvendësohen më kryq-eshtërthes.

Grotesku përftohet prej një lloj barazimi shpërpjestimor të figurave, gjendjeve dhe veprimeve të personazheve.

Në një luginë ne gjetëm të përziera me eshtrat e ushtarëve eshtër mushkash-tha gjeneral lietnanti, funksioni i njësimin të eshtërve të ushtarëve me ata të mushkave është theksimi i idesë se në luftë njeriu humbet çdo lloj identiteti, të gjithë janë një e tetëdhjetë e dy, më duket se edhe unë vetë jam një e tetëdhjetë e dy.

Në këtë situatë grotesku përftohet nëpërmjet njësimin të eshtërve të kolonelit të vdekur me eshtrat e vetë gjeneralit që është i gjallë.

Funksioni estetik-shprehja e ndëshkimit të rëndë të gjeneralit. Grotesku e njëson atë me kolonelin e vrarë nga një plakë shqiptare.

Të më qëllonte mua të këndoja një këngë të kësaj natyre për ushtarët që po mbledh, kushedi ç'gjë e llahtarshme do të dilte, ndërthurje e një dukurie qesharake me një tmerruese.

Përftesat më të dendura groteske në motërzimin e vitit '67 i japin edhe më dramacitet rrëfimit dhe i përshtaten më së miri natyrës intriguese të fabulës.

Në këtë sistem simbolik dhe ironizues kryq dhe eshtrat shënojnë përfundimin e tyre në asgjë, kurse thesi shënon fundin e mjerueshëm e të përbuzshëm.

3.2 Personazhet kryesore

Si personazhe kryesore na paraqiten:

Plaka Nice- e cila personifikon nënat e martirizuar dhe urrejtjen e pashuar të popullit shqiptar ndaj agresorëve. Në gjestin simbolik të hudhjes së eshtrave në këmbet e gjeneralit, *gjykon dhe egzekuton denimin për kolonelin Z.* ⁴

Gjenerali- është prototip i ushtarakëve më dëshira për pushtime. Ai është në konflikt të mprehtë me popullin shqiptar, vjen në Shqipëri më krenari dhe ndër, por krenaria dhe nderi e lënë shpejt.

Ai e provon se sa e rënde është të ndeshesh kudo më disfaten e turpshme, dëshmit e së cilës i mbledhe nëper mijëra thasë najloni.

Prifti- paraqet tipin tjetër të armikut të egër të popullit shqiptar. Ai u pasqyrua në karakter të gjallë më ngjyra psikologjike.

Prifti e shoqëron gjeneralin jo vetëm si fetar, por edhe si specialist për qeshtjet shqiptare, që zotëron mirë gjuhën shqipe dhe hiqet si njohës i së kaluares, psikologjisë dhe mentalitetit shqiptar.

Koloneli Z- Mbetet si një fantazmë, mirëpo përmendet shpesh, pos nuk del asnjëhere veçse në fund shohim eshtrat e tij në një thes të vjetër.

Ai e ka vrarë burrin e plakës Nice dhe ja ka përdhunuar të bijën katërmëdhjetëvjeçare.

Koloneli Z realizohet në dy plane: Përshkrimi i nënës se tij e nxjerr si zemër të mirësisë, ndërkaq përshkrimi i nënës Nice e nxjerr në pah anën e vërtetë të njeriut bishë edhe për shqiptarët edhe për ushtarët e tij, *si komandant i batalionit Blu që ishte.* ⁵

⁴ Kadare, Ismail, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, Onufri, 2001, f.208.

⁵ Kadare, Ismail, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, Onufri, 2001, f.218

3.3 Skena groteske

Ismail Kadare përshkruan skenë dhe pamje konkrete të ngjarjes dhe pamjes në të cilin ishte duke u kryer misioni, ai jep një pikpamje makabre të tmerreve të shkaktuara në luftën e cila ishte zhvilluar në tokat shqiptare.

Skenë groteske paraqitet atëherë kur gjenerali dhe prifti krijojnë ushtrinë e të vdekurve, duke zhvarrosur trupat e vdekur të ushtrisë së tyre, e çka nuk përmendet në roman por dihet se këta të fundit ishin nga Italia.

KREU IV

4.1 Fabula e romanit

Fabula e romanit është edhe më e veçanta edhe në letërsinë botërore, është edhe më tërheqëse. Ajo është ngritur mbi një veprim tmerrues, zhvarrimin dhe mbledhjen e eshtrave të ushtarëve të vrarë.

Një gjeneral i huaj dhe një prift vijnë në Shqipëri në fillim të viteve '60 për të zhvarrosur eshtrat e ushtarëve të vrarë gjatë luftës së dytë botërore duke nxjerrë nga toka mijëra skelete, gjatë 2 viteve ai krijoi ushtrinë e paparë të të vdekurve ose siç e quan edhe ai me ironi: armatën e madhe të Najlonit, kjo është edhe arsyeja që ai quhet " Gjeneral i ushtrisë së vdekur".

Fabula të Gjenerali i ushtrisë së vdekur ka njëherësh disa funksione: a) rikrijon itinerarin e krimeve dhe të dështimeve të ushtrisë pushtuese.

Endjet e gjeneralit dhe të priftit nëpër Shqipëri, duke kërkuar eshtrat e të vrarëve, rikrijojnë itinerarin e krimeve, të humbjeve dhe të dështimeve të ushtrisë së dikurshme të gjallë. Nëpërmjet këtij itinerari të krimeve, humbjeve dhe dështimeve dënohen emocionalisht bëmat e ushtrisë pushtuese.

b) Paraqet kalvarin e ndëshkimit moral të gjeneralit Gjenerali tërheq mbi vete gjithë mërinë dhe përbuzjen e shqiptarëve paqësor dhe liridashës, pasi u kujton atyre vuajtjet, mjerimin dhe vrasjet në luftë.

Kështu, kalvari i mbledhjes së eshtrave është njëherësh, edhe kalvari i turpërimit, dënimit dhe i ndëshkimit moral të gjeneralit, që është komandant i ushtrisë së vdekur, por që mund të jetë edhe krijues i mundshëm i një ushtrie të gjallë.

c) Zbulon thyerjen e moralit të gjeneralit Gjenerali, si përfaqësues ushtarak i një shteti të fuqishëm është tepër krenar përballë shqiptarëve, *që janë një popull i vogël.*⁶

⁶ Kadare, Ismail, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, Onufri, 2001, f.198.

4.2 Skena melodramatike

Skenë mjaft melodramatike është kur gjenerali që kryesonte misionin i gjen eshtrat e kolonelit në ballafaqimin me një plakë shqiptare (Nica), e cila e pati vrarë kolonelin me sëpatë, pasi ai i pati përdhunuar vajzën e saj 14-vjeçare, e cila pas kësaj fatkeqësie i dha fund jetës, ndërsa plaka Nicë e varrosi kolonelin tek pragu i portës së vet.

Kur në fshatin e saj erdhi gjenerali italian që mbledhte eshtrat, Nica i nxori eshtrat e kolonelit të mbledhura në një thes dhe ia hodhi gjeneralit para këmbëve, *në mes të një dasme dramaciteti që përjeton gjenerali në vetvete duke bere që gjenerali të ndjeje peshën e mëkatit , duke e barazuar veten më kolonelin Z, duke u zhytur në depresion.*⁷

4.3 Mbledhja e eshtrave të ushtarëve të vrarë

Misioni për zhvarrimin dhe mbledhjen e eshtrave filloi më 29 tetor në trevat e Shqipërisë, në të cilin ishin nisur për ta kryer edhe pse ishte mjaftë e veshtirë sepse ardhja e tyre aty banorëve do ti rikujtonte gjëra të tmerrshme në vendin e tyre.

Kryqi, eshtrat dhe thesi kishin një domethenje ,eshtrat dhe thesi tregonin rrugëtimin e tyre në pafundesi ndërsa kryqi fatin e tyre në asgjë.

Si identifikim i trupave të vdekur u ishte vënë një medaljon të cilin në bazë të tyre dallohej se kush ishte, mirëpo përveq trupave të ushtarëve kërkohesh edhe një tjetër trup i cili konsiderohej i zhdukur i cili ishte i njohur si Koloneli Z e që ai kishte bërë gjëra të turpshme dhe të pamoralshme gjatë kohës sa kishte qenë aty thuhet se kishte vrarë burrin e plakës të quajtur Nice dhe kishte përdhunuar vajzën e saj katërmbëdhjetë vjeç për këtë arsye edhe e kishte vrarë *plaka Nice dhe eshtrat e tij i kishte vëndosur poshtë pragut të shtëpise së saj.*⁸

Pasi u nisen Gjenerali vështronte tokën e gërmuar dhe, herë fytyrat e varrmihësve, ato ishin të qeta dhe hijerënda, ai u kërkoi atyre që të lëviznin më shpejtë, që varret të hapeshin sa më parë dhe sa më parë të gjindeshin të gjithë të rënët dhe atëherë ai do të nxirrte lisat dhe lisat do të mbusheshin më kryqe të vegjël dhe çdo kryq do të kishte një ushtar të gjetur.

Tingulli i goditjes së hekurit tani vinte i thellë si nga fundi i dheut dhe befasisht gjenerali ndjeu një ankth në gjithë qenien e tij dhe tha po sikur ushtari të mos gjindet dhe po sikur hartat të mos jenë të sakta dhe të detyrohemi të gërmojmë në dy vende, në tre, në dhjetë, për të gjetur një skelet, shumë herë e pyeti priftin i shqetësuar .

Dhe prifti ja kthen përse të shqetësoheni, toka këtu është e qëndrueshme dhe atë çka e ka brenda e ruan për shumë vjet.

⁷ Kadare, Ismail, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, Onufri, 2001, f.200.

⁸ Kadare, Ismail, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, Onufri, 2001, f.203.

Toka ishte plot gurë të vegjël, që lëshonin një tingull të mbytur dhe kur preknin në metalin e lopates gjeneralit i kujtoheshin copëza tregimesh të ushtarëve veteranë, që kishin shkuar në shtëpi përpara nisjes së tij për tu interesuar për varret e shokëve të tyre të mbetur nëpër Shqipëri.

Përse nuk gjejmë gjë pyeti gjenerali dhe derisa më njëlloj nervozizmi diku aty afër një gërmues bërtiti duke thënë e gjeta ,të gjithë vrapuan ,përderisa gërmuesi filloi të nxirrte eshtrat jashtë më lopatë, në pamjen e tyre nuk kishte asgjë te frikshme, veçse ato ishin përzier me dheun e shkrihtë dhe dukeshin si copa drunjsh.

Pasi nxorrën eshtrat dy puntorë vrapuan të kamjoni dhe pasi shkuan aty gjetën diqka të vogël midis eshtrave,ai ishte medalioni ata ja treguan gjeneralit ai pasi e pa ju tha është tmedalioni i ushtarëve tanë dhe e dini përse e kemi këtë medalion?

*Që të na gjejnë trupin, në qoft së vritemi.*⁹

⁹ Kadare, Ismail, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, Onufri, 2001, f.225.

KREU V

5.1 Fantastikja dhe realja

Në romanin gjenerali i ushtrisë vdekur fantastikja dhe realja shkrihen në një botë të larmishme të imagjinates, duke pasqyruar fatin e kobshëm të një ushtrie pushtuese në e trojet e Shqipërisë.

Në roman realja ka të bëjë me mbledhjen e eshtrave të ushtarëve të vrarë gjatë luftës së dytë botrore diku rreth viteve të 60-ta të cilët kishin mbetur në tokat shqiptare dhe zhvarrimi i tyre i prirë nga një gjeneral dhe një prift i cili ishte nisur kinse i njihte, zakonet dhe traditat e vendit.

5.2 Bota e gjallë dhe bota e vdekur

Në romanin “Gjenerali i ushtrisë vdekur” shkrimtari përdore një fabule të pabesueshme, ku në këtë mision bashkëjetojnë dhe bashkëveprojnë të gjallët më të vdekurit.

Të gjallët duke gërmuar zbresin në botën e të vdekurve, në Handes, ndërkaq të vdekurit ngrihen mbi tokë në botën e të gjallëve. .¹⁰

5.3 Elemente të baladave shqiptare në roman

Baladat shqiptare janë formë e veçantë e letërsisë gojore dhe të shkruar brenda së ciles janë të përziera elementet epike, dramatike, dhe lirike.

Dhe duke bartur në vete elemente të lashtësis, më së shpeshti ato arrijnë të freskëta dhe tejet intriguese artistikisht, deri në ditët tona.

Strukturat themelore të tyre janë të njëjta ashtu si në pikën themelore të sprovimit etik.

Në romanin “Gjenerali i ushtrisë vdekur” shkrimtari Ismail Kadare e shkroi gjithnjë sipas formules se kombi shqiptar është komb kulturor ndaj vendeve tjera, sikurse tek baladat shqiptare, që vetë populli shqiptar dallohet me disa virtyte, siç janë: Tradita, besa, mikpritja, etj gjëra që e kanë dalluar popullin shqiptar nga vendet e tjera dhe u kanë jap një mendim të mirë për vendin.

Po ashtu elemente të baladave në të cilën thuhet në roman hynë edhe bashkëjetesa e të gjallëve më të vdekur.

¹⁰ Kadare, Ismail, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, Onufri, 2001, f.222.

PËRFUNDIME:

Si përfundim në lidhje me këtë punim mund të themi se qëllimi i kësaj teme diplome është trajtimi i veprës letrare të shkrimtarit tonë të mirënjohur Ismail Kadaresë, përkatësisht romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” i cili është përkthyer në shumë gjuhë të botës.

Në romanin e tij i cili u përhap shumë Ismail Kadare tërhoqi vëmendjen e kritikeve më talentin, stilin e tij në mënyrë origjinale ai i qaset trajtimit të luftës, këtij fenomeni shoqëror, mjaft kompleks, këtij absurdi, që sjell shkatërrimin individual, psikik e material, po ashtu sjell tragjedinë kolektive kombëtare.

Kadare në këtë rast niset nga pasojat, pra është një vision paqësor i luftës, por në të vërtetë është më e tmerrshme se vetë lufta.

Lufta ka kohë që ka mbaruar, por njerëzit vështirë, që mund ta harrojnë atë, ajo ka lënë gjurmë të pashlyeshme në psikikën e njerëzve si tek rasti i plakes Nice.

Ismail Kadare dëperton thellë në etikën e popullit shqiptarë, duke e njohur thellë mendësinë e psikologjinë e tij.

Në romanet e Kadaresë "*dimensioni folklorik i narracionit e shtyn atë larg fiksjonit standard letrar*".¹¹

Shqiptari i shtyrë nga instikti, nga dashuria e pakufishme për atdheun, mbrojtja e të cilit është nderi më i madh i tij, në lufte ai është i egër e i pamëshirshëm si në rastin e Nik Martinit, ndërsa në jetë shqiptari është bujar, mikpritës e puntëor.

Humanizmi vlerat e larta njerzore të tij duken më se miri kur pas kapitullimit të Italisë, shqiptaret nuk vrisnin ushtarët italianë, por i strehonin ata nga asgjësimi gjerman-viktima e mbronte pushtuesin e deri para pak qasteve nga aleati i tij i mëparshëm.

Rast ky i rrallë, ndoshta edhe i veçantë në historinë e njerëzimit.

Këtu shkrimtari më mjeshtëri e ka futur ditarin e ushtarit italian si një dëshmi të drejtpërdrejtë dhe njëherësh për të futur diçka të butë, humane në këtë tregim të tmerrshëm.

Kadare nuk tallet më kufomat, por me ata që i udhëheqin në luftë, me ata që janë në gjendje t'i hedhin edhe sot.

Vepra ka porosi të thellë humane dhe kundërmilitariste-prodhimi, pasojat e vetme të luftës janë kockat dhe tragjeditë njerëzore.

Ky roman i botuar në Paris më 1970, në përkthim të shumë gjuhëve hapi rrugën për popullaritetin e Ismail Kadaresë në Francë dhe në arenën ndërkombëtare.

¹¹ Jeta e re”, revistë letrare, nr.2, viti XLII, Prishtinë, 2011, f.234

Romani i shkëlqyer i këtij shkrimtari të ri shqiptar ngrihet qysh ne fillim, mbi anektodën makabre.

Ai largohet prej humorit të zyrtë që vetë subjekti duket sikur e kërkon, dhe nëse, për mënyrën të procedimit, të kujton Buzzatin nuk mund të vihet re, njëherazi, se romani “Gjenerali i ushtrisë vdekur” nuk është pavarësisht nga përshtypja e parë, një parabolë e mirëfilltë dhe aq më pak një përsiatje metafizike.

Në rastin më të skajshëm, ky gjeneral që zhvarrosë ushtarë të cilët nuk i ka njohur ndonjëherë, për t’i ngritur në një ushtri fantazmash mund të ishte pothuajse një simbol, një simbol, me kusht që kërkimi i marrosur të mos mbante vulën e një realizmin të rrebtë, por gjithsesi, të çuditshëm.

Por të mos ngutemi në gjykimin tonë ajo çka gjallon, thellësisht, në mënyrë njëherazi magjepëse, siç mund të ndodhë në një magji.

Më fjalë të tjera Ismail Kadare edhe pse i përmbahet stilit pavetor të rrëfimit, në të vërtetë, na sjellë një tregim subjektiv. Ajo çka shohim ne nuk është fjala vjen, Shqipëria e autorit, por ajo e gjeneralit.

Robert Escaropi në parathënjën e tij për këtë roman, vëren më një nuhatje krejt të thellë se përgjatë dy vjet germimesh endacake, ai gjenerali nuk sheh gjë tjetër nga ky vend mesdhetar, veç baltërave të vjeshtës dhe dëborave të dimrit.

Përmes kronologjisë së rrebtë dhe dramatike të rrëfimit, Ismail Kadareja i mohon atij pranverën, po ashtu i mohon edhe buzëqeshjën, gjithçka fillon me shiun dhe dëboren dhe mbaron më erën.

Ismail Kadareja i lëjon të shohë heroit të vet pra të tregojë vetëm çka i përshtatet atij, domethënë, atë që përputhet më natyrën e tij dhe posaçërisht, atë të një gjenerali që vjen në tokë të huaj, njësoj siç kishin ardhur ushtria fashiste, mbledhjen e provave dhe pasojave të pakundërshtueshme të humbjes se tyre.

Tërë shkallëzimi dramatik i romanit mbështetet mbi këtë përmbysje të një gjenerali dhe një ushtrie që vjen për të mbledhur eshtrat e një ushtrie fantazmë.

BIBLIOGRAFIA:

BIBLIOGRAFIA DADO, Floresha (1997), Proza nëpër teknikat poetike, Toena, Tiranë.

DE BIASI (1982), La legende de Saint Julien l'Hospitalier, La critique Genetique.

KADARE, ISMAIL (1962), Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Zëri i Rinisë, Tiranë.

KADARE, ISMAIL (1963), Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Naim Frashëri, Tiranë.

KADARE, ISMAIL (1967), Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Naim Frashëri, Tiranë.

KADARE, Ismail (1990), Ftesë në studio, Tiranë.

KADARE, ISMAIL (1996), Dialog me Alain Bosquet, Onufri, Tiranë. **KADARE, Ismail** (2001), Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Onufri, Tiranë.

KUÇUKU, Bashkim (2000), Kadare në 40 gjuhët e botës, Onufri, Tiranë. **SILIQI, Drago** (1989), Në kërkim të së resë, N. Frashëri, Tiranë.

Kadare, ISMAIL, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Onufri, Prishtinë, 2015.